

NJOFTIM

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË SHPALL NJOFTIMIN PËR KONKURIM TË HAPUR, PËR VENDIN E LIRË TË PUNËS:

“Për personel akademik me angazhim me kohë të pjesshme, për Semestrin Pranverë 2025, pranë Departamentit të Biznesit, në Fakultetin e Ekonomisë”.

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Pedagog me angazhim me kohë të pjesshme, për semestrin “Pranverë 2025”
- Mbështetje për nevojat e Departamentit dhe Fakultetit

Kriteret bazë (skualifikuese):

1. Kandidati duhet t'i përkasë kategorisë Profesor me Doktoraturë në fushën e Financës. Këta kandidatë përjashtohen nga kriteti i mesatares.
2. Në mungesë të kandidatëve të mësipërm do të përzgjidhen kandidatët me gradën “Doktor” në fushën e Financës. Mesatarja e notës, për çdo diplome që zotërojnë këta kandidatë të jetë jo më e vogël se 9 (nëntë).

Kriteret shtesë

1. Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhëve të tjera të BE, të nivelit B2-C1 jep përparësi.
2. Të kenë njohuri/eksperiencë mbi metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.
3. Të ketë botime shkencore dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore.
4. Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të jenë të motivuar për të punuar në grup.
5. Të jenë të aftë të garantojnë standartin e cilësisë dhe efikasitetin në punë.

Kritere të përgjithshme që duhet të plotësojë/në kandidati/ët

- Të jetë shtetas/e shqiptar/e.
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të jetë i aftë nga ana shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse.
- Të zotëroj aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkuron;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese etiko-profesionale, të bashkëpunimit dhe të punës në grup me kolegët dhe eprorët;
- Të njohë një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, të çertifikuara sipas testeve të njohura nga MAS. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje si dhe të mos jetë person nën hetim për vepra të rënda penale;
- Kandidati nuk duhet të ketë patur background negativ në eksperiencat e mëparshme në punë dhe të mos jenë marrë ndaj tij masë disiplinore “largim nga puna”;
- Të mos jetë në proces gjyqësor me Universitetin “Isamil Qemali” Vlorë;
- Të mos ketë vepruar ose propaganduar në drejtim të prishjes së imazhit të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë dhe autoriteteve/organeve drejtuese të saj, në median vizive dhe/apo të shkruar, rrjetet sociale etj.

Dokumentacioni i kërkuar

- Letër interesi për pozicionin (formulari i aplikimit i plotësuar nga aplikanti, gjendet në adresën www.univlora.edu.al),
- Jetëshkrim/Curriculum Vitae,
- Diploma/t universitare (kopje te noterizuara),
- Lista e notave të studimeve universitare (origjinal),
- Tituj akademik ose grada shkencore (kopje te noterizuara),
- Dëshmi e kualifikimeve, trajnimeve apo specializimeve (kopje te noterizuara),
- Artikuj të botuar, projekte shkencore, etj,
- Libreza e punës ose vërtetim zyrtar për periudhën kohore të punësimit nga organi tatimor (origjinal ose kopje të noterizuar),
- Rekomandime nga profesor/profesor i asociuar ose/dhe punëdhënësi i fundit,
- Referenca që provojnë vlerësimet pozitive në punë,
- Dëshmi e njohjes e gjuhës së huaj (origjinal ose kopje të noterizuar),
- Dëshmi e njohjes se kompjuterit (origjinal ose kopje të noterizuar)
- Raport mjekësor për aftësinë në punë, lëshuar 3 muajt e fundit (origjinal),
- Vendim i gjendjes gjyqësore (dokument i lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor ku kandidati ka vendbanimin),
- Letërnjoftimi ID (fotokopje)

Kandidatët të cilët dorëzojnë dokumentacion të pa noterizuar, ose kanë mungesë në dokumentacion nuk do të merren në shqyrtim nga komisioni

Diplomat, çertifikatat, gradat dhe titujt e fituar në institucione të huaja arsimore, të shoqërohen me çertifikatën e njehsimit, bazuar në nenin 92 të Ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”

Mënyra e aplikimit

Dokumentat duhet të dorëzohen vetëm nëpërmjet shërbimit postar në adresën:

Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë.
Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës.

Aplikim për punësim/pozicioni i punës:

“Për personel akademik me angazhim me kohë të pjesshme, për Semestrin Pranverë 2025, pranë Departamentit të Biznesit, në Fakultetin e Ekonomisë”.

Lagja: “Pavarsia”, Rr: “Kosova” 9400 Vlorë, Shqipëri

Afati për aplikim

✓ Afati për të aplikuar është 10 ditë kalendarike. Ky afat fillon nga dita e parë e shpalljes në faqen zyrtare të internetit të UV-së. (njoftimi u publikua në datën 20.03.2025 dhe afati përfundon në datën 29.03.2025).

✓ **Dokumentacioni i dorëzuar në shërbimin postar pas datës 29.03.2025 do t’i kthehet aplikantit pa veprime.**

Fazat në të cilat kalon konkurimi

✓ Konkurimi do të kryhet në dy faza: Vlerësimi i dosjes dhe intervista e drejtpërdrejt e kandidatit.

-Vlerësimi i dosjes parashikon verifikimin e dokumentave nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin vakant, vlerësimin e arsimimit, përvojës në punë, trajnimet e kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse si dhe vlerësimet pozitive,

-Intervista e strukturuar me gojë.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Struktura e ndarjes së pikëve të vlerësimit të kandidatëve, është si më poshtë vijon:

- 70 pikë për vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar, e ndarë në: 30 pikë arsimimi, 20 pikë përvojë në mësimdhënie, 10 pikë për trajnime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse, 10 pikë për vlerësimet e rezultateve individuale në punë.

- 30 pikë intervista e strukturuar me gojë, ku, me një grup të njëjtë pyetjesh për të gjithë kandidatët, **vlerësohen njohuritë, formimi i tyre, aftësitë komunikuese, bashkëpunuese etj.**

Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

Komunikimi dhe njoftimi i kandidatëve do të mundësohet nga zyra e burimeve njerëzore të UV-së nëpërmjet postës elektronike.